



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 11P/13 prot.

Pukë, më 12.07.2026

VENDIM

Nr. 30 datë 17.07.2026

PËR MIRATIMIN E PLANIT VENDOR TË INTEGRITETIT 2026–2029 TË BASHKISË PUKË

Këshilli Bashkiak Pukë në mbledhjen e tij të datës 17.07.2026, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar; Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike"; Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", të ndryshuar; Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"; Ligjit nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik", të ndryshuar; pasi shqyrtoi relacionin përkatës dhe dokumentin strategjik "Plani Vendor i Integritetit 2026–2029 i Bashkisë Pukë",

VENDOSI:

1. Të miratojë **Planin Vendor të Integritetit 2026–2029 të Bashkisë Pukë**, sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi, i cili është pjesë përbërëse dhe e pandashme e tij.
2. Plani Vendor i Integritetit 2026–2029 të shërbejë si dokumenti strategjik i Bashkisë Pukë për forcimin e integritetit institucional, rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë, etikës në administratën publike, si dhe për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave.
3. Të gjitha drejtoritë, sektorët, njësitë administrative dhe strukturat e Bashkisë Pukë të zbatojnë masat, objektivat dhe aktivitetet e përcaktuara në Planin Vendor të Integritetit, në përputhje me përgjegjësitë dhe afatet e përcaktuara në të.
4. Koordinator i integritetit, në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, të koordinojë zbatimin e Planit Vendor të Integritetit, të ndjekë realizimin e masave të parashikuara dhe të sigurojë bashkërendimin ndërmjet strukturave përgjegjëse.
5. Drejtoritë dhe sektorët përgjegjës të raportojnë periodikisht tek koordinatori i integritetit mbi ecurinë e zbatimit të masave të planit, sipas afateve dhe indikatorëve të përcaktuar në dokument.
7. Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në bashkëpunim me koordinatorin e integritetit dhe strukturat përgjegjëse, të organizojë aktivitete informuese, trajnuese dhe ndërgjegjësuere për punonjësit e Bashkisë, me qëllim promovimin e etikës, integritetit institucional dhe zbatimin e standardeve të përcaktuara në plan.

8. Sektori përgjegjës për komunikimin publik dhe teknologjinë e informacionit të publikojë këtë vendim, së bashku me **Planin Vendor të Integritetit 2026–2029**, në web-in zyrtar të Bashkisë Pukë, në rubrikën përkatëse të dokumenteve strategjike, si dhe të sigurojë aksesin e publikut në përputhje me legjislacionin për të drejtën e informimit dhe transparencën.

9. Ngarkohet Administrata e Bashkisë Pukë për zbatimin e këtij vendimi.

10. Ky vendim hyn në fuqi SIPAS LIGJIT 139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

11- Vendimi u shpall me dt.17.07.2026

Vota te vlefshme gjithsej 9

Vota pro 9, Vota kunder 0, Vota abstenim 0.

Sekretari

Ndriçim ASLLANAJ



Kryetari

Gjon GJOKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 540/I prot.

Shkodër më 2207.2026

Lënda: Mbi Vendimin Nr.30, datë 17.07.2026 të Këshillit Bashkiak Pukë.

KËSHILLI BASHKIAK PUKË

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", të ndryshuar, neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 21, datë 05.02.2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 39, datë 20.02.2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, ligjit nr.9131/2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike" i ndryshuar, ligji nr.9367 datë 07.04.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimi e funksioneve publike" të ndryshuar, të ligjit nr.119/2024 "Për të drejtën e informimit", ligjit nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" të ndryshuar shkresës 1132/4 datë 20.07.2026 të Këshillit të Bashkisë Pukë, shqyrtoi **VKB Nr. 30 datë 17.07.2026** "Për miratimin e planit vendor të integritetit 2026-2029 të bashkisë Pukë".

Pas shqyrtimit, Prefekti autorizon procedim të planit vendor të integritetit.

Ju sjell në vëmendje respektimin e afatit ligjor mbi procesin e konsultimit publik referuar nenit 15 të ligjit Nr.146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" i ndryshuar.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,


PREFEKTI
Holta DUDA
